



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:032844

Datë: 06.04.2022

Numri i dokumentit: 02891547

PKR.nr.44/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët Sami Sharraxhia dhe Veton Ademaj anëtar, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. G nga P, lagja D. rruga “ M. K “ nr. ..., për shkak të veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 178 e lidhur me nenin 28 të KPRK-se, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP.nr.115/17 të dt. 25.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurores së shtetit Valbona Disha - Haxhosaj, të akuzuarit F.G dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Gezim Kollçaku, si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. Burim Halili nga Prishtina, me dt.28.03.2022 mori dhe shpalli dhe me datë 06.04.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.G, i biri i I dhe nënës M e gjinisë G, i lindur me dt. ne P, lagja D , në rr" M.K” nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor në qebaptore, i martuar baba i ... fëmijëve identifikuar me numër të letërnjoftimit, shqiptar shtetas i R. se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 14.09.2017, rreth orës 15.30 , në rrugën “ M. K “ P, duke vepruar në gjendjen të tronditjes së fort mendore të shkaktuar pa fajin e tij por me fajin e viktimës, me armë tenton ta privoi nga jeta viktimën F. Ll nga P, në atë mënyrë që i pandehuri F pasi që ishte njoftuar nga bashkëshortja e tij se prindi i tij I ishte goditur me sopat për vdekje në koke nga ana e të pandehurit F (këtu viktimës), i pandehuri F i tronditur fort nga njoftimi, merr armën e llojit TT kalibër 7.62 mm, dhe nis të drejtojë te shtëpisë se viktimës F, me ç’rast fut dorën brenda portës hyrëse të shtëpisë se viktimës dhe nga distanca rreth 5 metra shtie shtatë herë me revole në drejtim të viktimës F, i cili në ato momente ishte në ballkonin e shtëpisë se tij, mirëpo nuk kishte arritur ta godet.

-Me çka ka kryer veprë penale të vrasjes e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore e mbetur në tentativë nga neni 180 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7,28,41,42,46,49,50,51,52,73,74, 75, nenit 180 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe neneve 365 të KPPRK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i përcaktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një)vit e 6 (gjashtë) muaj, ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës prej 2 (dy) vite nuk kryen veprë të re penale.

I akuzuari F. G obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 150(një qind pesëdhjetë euro), si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguaj shume prej 50 (pesë dhjet euro), si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej 50 (pese dhjetë euro), te gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av Burim Halili nuk pati kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP.nr.115/17 të dt. 25.01.2018, kundër të akuzuarve: F.LL nga Peja për shkak të veprave penale: vrasje nga neni 178 të KPRK-së, vrasje në tentativë në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme, nga neni 178 lidhur me nenin 28 e lidhur me nenin 12 par. 3 të KPRK-së, dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, F.G nga Peja, për shkak të veprave penale: vrasje e mbetur ne tentativë nga neni 178 e lidhur me nenin 28 te KPRK-se dhe mbajtja në pronësi kontrole ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata themelore në Pejë departamenti për Krime të Rënda ka mbajte shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje dhe ka marr aktgjykim P.nr.06/2018 të dt.30.11.2018 ashtu që i akuzuari F. Ll. është shpall fajtorë për veprë penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK-së dhe për veprë penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 13 vitesh. Në dënim më burg i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.14.09.2017 e tutje. I është shqiptuar dënim plotësues konfiskimi i armës dhe municionit si dhe është obliguar që gjykatës në emër të shpenzimeve të procedurë penale. I dëmtuari Y.G është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim. I akuzuari F.LL është liruar nga aktakuza për vepre penale të vrasjes në tentativë në rrethana të mbrojtjes së nevojshme nga neni 178 lidhur me nenin 12 par. 1 të KPRK-së për shkak se nuk përbën veprë penale. I dëmtuari F.G është udhëzuar në kontest civil.

I akuzuar F.G është shpall fajtorë për veprë penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 vite i cili dënim nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afat prej 1 viti nuk do të kryej veprë të re penale dhe veprë penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ku është dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 500 euro. Të njëjtit i është konfiskuar arma dhe një karikator të cilat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të asgjësohen. I njëjti është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe për viktimat e krimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë kanë parashtruar ankesë: përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar Y,G mbrojtësi i të akuzuarit F.LL av. Bekë Laçi, mbrojtësi i të akuzuarit F.G, av Muharrem Hoti.

Gjykata e Apelit me aktgjykim PAKR.nr.107/2019 të dt. 04.04.2019 duke aprovuar ankesën e përfaqësuesit Y.G ka ndryshuar aktgjykimin sa i përket të akuzuarit F.Ll, për shkak të vendimit mbi dënim ashtu që për veprën penale vrasje nga neni 178 të KPRK-së i cakton dënim me burg në kohë zgjatje prej 15 vitesh, kurse për veprën penale mbajta në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dënimin me burg prej 2 vitesh e merr si të vërtetuar, dhe më pas i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 16 vitesh, në pjesën tjetër aktgjykimi sa i përket të akuzuarit F.Ll mbetet i pa ndryshuar. Ankesa e të akuzuarit F.Ll lidhur me pikën 1/1a dhe 1b refuzohet si a pabazuar.

Me rastin e ankesë së përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit F. dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit F. G sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi sa i përket pikës 2/2a, për vepër penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për të akuzuarin F. G anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Aktgjykimi përkitazi me veprën penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së përkitazi të akuzuarin F. G mbetet i pa ndryshuar sepse nuk ishte ankimuar.

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të F. Ll si i dëmtuar dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F. G janë jo lëndore.

Aktgjykimi në pjesën liruese që kishte të bënte me të akuzuarin F. Ll mbetet i pa shqyrtuar sepse nuk ishte ankimuar.

Siç rrjedhë nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i cekur më lartë çështja është kthyer në rigjykim vetëm sa i përket pikës 2/2a që ka të bëjë me të akuzuarin F. G për vepër penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Andaj shqyrtimi gjyqësor rishtas ka filluar vetëm për të akuzuarin F. G dhe vetëm veprës penale në fjalë, pasi që pjesa tjetër e aktgjykimit P.nr.06/2018 të dt.30.11.2018 është vërtetuar me ndryshimet e cekura si më lartë.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.28.03.2022 prokurorja para se të lexoi aktakuzën ka deklaruar se: “ - meqenëse prokurori i çështjes Haxhi Sinanaj ka dal ne pension dhe lënda - akuza me është bart mua në kompetencë, për te përfaqësuar në gjykatë, pasi kam marr shkresat e lëndës dhe pasi qe i kam analizuar ne tërësi duke përfshire edhe raportin për gjendje e shëndetit mendor të punuar për të pandehurin F. G, por edhe provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit të mëparshme gjyqësorë në konsultim edhe me kryeprokurorin bënë rikualifikimin e veprës penale nga vrasja e mbetur në tentative nga neni 178 te KPRK-se, në vepër penale të vrasjes në tentative e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 lidhur me nenin 28 te KPRK-se. Prokurorja ka bërë edhe përshkrimin faktik të veprës si në dispozitiv të cekur më lartë.

Më pas prokurorja ka lexuar aktakuzën e ndryshuar dhe ri kualifikuar. Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij, ashtu që të akuzuarit i ka dhënë mundësin që të deklarohet për fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari F. G ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe deklaroi se e pranon fajësinë për veprat penale të ri kualifikuar nga ana e prokurores.

Prokurorja e shteti ka deklaruar s'pajtohet plotësisht me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit F i cili pranim korrespondon edhe me shkresë në bazë të cilave është ngritur aktakuza. I propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar *av. Burim Halili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.*

Mbrojtësi i të akuzuarit *Av. Gëzim Kollçaku ka deklaruar se pas konsultimit me të mbrojturin e tij dhe pas që i njëjti ka kuptuar të gjitha privilegjet dhe kufizimet që dalin nga pranimi i fajësisë dhe duke u bazuar dhe në provën materiale në lidhje me gjendjen mendore i njëjti me vullnet të plotë bëri pranimin e fajësisë, andaj dhe kërkoi nga gjykata që ky pranimin të pranohet si i vullnetshëm dhe pa kurrfarë presionit nga jashtë apo ndonjë person tjetër i tretë.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni pasi ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Duke pasur parasysh të lartcekurat dhe provat në shkresë të lëndës gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së apo përjashtimin e përgjegjësisë penale, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: “- meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale të ri kualifikuar unë në tërësi mbes pranë përshkimit faktik juridike të veprës penale, i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë ta dënoi sipas ligjit si dhe obligoi në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Me rastin marrjes së vendimit mbi dënim si rrethanë lehtësuese i propozoi gjykatës që të merr parasysh pranimin e fajësisë, sepse rrethana të tjera të cilat e kanë shtytë të pandehurin të kryer veprën penale janë vlerësuar kur dhe është bërë rikualifikimi i veprës penale rrethana renduese në këtë rast prokuroria nuk ka gjetur”.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar *av. Burim Halili në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: “-në bazat e informacioneve që unë i kam nga vëllai i palës së dëmtuar që me ka autorizuar raportet në mes të këtyre dy familjeve kanë patur acarime për kohë të gjatë nuk janë siç u tha këtu sikurse të kishte ndodhur vetëm një rastë i vetëm, neve na vjen keq shumë për humbjen e babait të tyre të ndjere, por ajo që tani në këtë momente i interesoi vëllai të palës së dëmtuar (F.LL tani i ndjerë) është që të ketë edhe një premtim dhe zotim se i njëjti nuk do të pengohet në shfrytëzimin e pronës së tij e cila gjendet e ngjitur me pronën e tyre, e besoi që një konfirmim nga ta kishin me marrë edhe Gjykata. Ndërkaq nuk ka kërkesë për dëmshpërblim”.*

Mbrojtësi i të akuzuarit *av. Gëzim Kollçaku në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar:”- i mbrojturi im bëri pranimin e fajësisë, andaj kërkova nga gjykata që përveç pranimit të fajësisë si rrethanë lehtësuese të merret edhe provokimet e vazhdueshme nga ana e viktimës që ka zgjatur me vite deri në ditën kritike. Si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i mbrojturi im ditën kritike ka qene 4 herë i plagosur nga ana e viktimës po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret pacenueshmëria e të mbrojturit tim gjerë me tani, rrethanat familjare që do të thotë*

është i martuar prind i tre fëmijëve, pendimin e tij, dhe te gjitha këto rrethana lehtësues të merren si rrethanat posaçërisht lehtësuese dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të mbrojturit tim ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar me të cilin dënim konsiderojmë se do të përmbushen të gjitha kushtet ose qëllimet për të cilën shqiptohet ky dënim”.

I akuzuarit *F. në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: “-se pajtohem me fjalën përfundimtare me mbrojtësin e tij, i vjen keq qe ka ndodhur, nuk ka diçka tjetër për te thënë”.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin F. G për veprën penale të ri kualifikuar nga ana e prokurores si më lartë , bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provat që gjenden në shkresa të lëndës siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër ...-...-..., foto-albumi i vendit të ngjarjes raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes, lista e dëshmive të dt.14.09.2017, raportet e hetuesve policorë me numër të njëjtë të dt.14.09.2017, dt. 15.09.2017, dt. 18.09.2017, dt. 20.09.2017 dhe dt.27.09.2017, raporti i spitalit regional i emergjencës në Pejë me numër prot... të dt.14.09.2017 për viktimën I. G i lëshuar nga M.Sh. V.-specialist internist, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të dt.15.09.2017, vërtetimi mbi konfiskimin e gjësendeve të konfiskuara nga i pandehuri F. G raporti i ekzaminimit balistik me numër AKF/.....-.../..... të dt. 25.10.2017, i lëshuar nga Agjensioni i Kosovës për Forenzik në Prishtinë, raporti mbi ekzaminimin e gjurmëve të barotit me numër AKF/.....-.... të dt. 13.10.2017, i lëshuar nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, nga raporti i ekspertimit të ADN-së në numër AKF/.....-...../.....-.... të dt. 17.11.2017 i lëshuar nga Agjesioni i Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, fletë lëshimi me epikrizë për të akuzuarin F. G nr.7622 dhen nga Spitali Regional reparti i kirurgjisë në Pejë dt.22.09.2017, raporti i ekzaminimin e gjurmëve papilare me numër AKF/...../.....-...../.....-..... të dt.01.12.2017 i lëshuar nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë në Prishtinë, raporti i autopsisë me numër i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor N. U., dhe raporti për gjendjen mendore të akuzuarit F. G dhënë nga Instituti i Psikiatris Forenzike në Prishtinë, me numër prot.../..... të dt.13.07.2018 i përpiluar nga Dr.A.B.- psikiatër , Dr. Arsim Gashi – psikiatër forenzikë dhe Dr.Sh.H. –Psikiatër dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari e ka pranuar fajësinë, mbajtës i familjes dhe faktit se për gjykatën nuk ka rrethana të njohura se i njëjti të ketë qenë i dënuar më parë. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti asgjë.

Për veprën penale për të cilën që i vihet në barr të akuzuarit e që gjykata e shpalli fajtor parashihet dënim me burgim prej 1 deri në 10 vite prugim. Por, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht në rastin konkret bazuar në dispozitën e nenit 52 e lidhur me nenin 75 të KPPRK-së. Me nenin 52 të KPRK-së parashihet se gjykata mund të shqiptoj dënim me kusht edhe në rastin kur për veprën penale është paraparë dënimi me burgim deri në 10 vite burgim, pasi që të aplikoj dispozitat për zbutje. Në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 75 të KPRK-së si dispozitë për zbutje të dënimit duke marr parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, si dhe faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë. Me dispozitën e nenit 28 par. 3 të KPRK-së parashihet që presoni që tenton të kryej vepër penale dënohet sikur kur të kishte kryer vepër penale, por dënimi mund të zbutet.

Andaj duke u gjendur para këtyre rrethanave të cekura si më lartë të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se dënimi i përcaktuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit

e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprës penale konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit Av. Burim Halili në seancë gjyqësore deklaroi se nuk ka kërkesë për dëmshpërblim andaj gjykata nuk e udhëzoi në kontest civil.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2018:032844, 06.04.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.